



Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029

— DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA —

Përmbajtja:

Përmbajtja:	1
I HYRJE	3
II STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME	4
2.1. PRIORITETET	5
2.1.1. BUJQËSI E QËNDRUESHME DHE MODERNIZIM I SEKTORIT AGRAR	5
2.1.2. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I MJEDISIT	5
2.1.3. ZHVILLIMI I AGROTURIZMIT DHE I SEKTORIT TË TURIZMIT RURAL	6
2.1.4. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PÛRKRAHJA E BIZNESEVE LOKALE	6
2.1.5. ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PÛRKUJDESJA SOCIALE	6
2.1.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE E QËNDRUESHME DHE SHËRBIMET PÛR QYTETARË	6
2.1.7. PROMOVIMI I KULTURËS, PÛRKRAHJE PÛR TË RINJTË, PROMOVIMI I TRASHËGIMISË	6
2.2. ZOTIMET	6
2.3. SYNIMET	7
III FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	8
3.1. Zhvillimi i agroturizmit dhe i turizmit rural	8
3.2. Investime në infrastrukturë turistike dhe mjedisore	8
3.3. Promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe organike	8
3.4. Zhvillimi i infrastrukturës bazë për bujqësinë dhe për mjedisin	8
3.5. Fuqizimi i kapaciteteve lokale dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	8
3.6. Nxitja e turizmit kulturor dhe e trashëgimisë lokale	8
3.7. Lehtësimi i procedurave për investime dhe ndërmarrësi	9
3.8. Parku ekoturistik dhe edukativ	9
3.9. Tregu i produkteve lokale dhe ekologjike	9
3.10. Festivali i verës dhe i kulturës së Rahovecit	9
3.11. Zhvillimi i infrastrukturës për sportet ekstreme dhe rekreative	9
3.12. Iniciativa për përdorimin e energjive të rinovueshme	9
3.13. Programi për rinovimin dhe rregullimin e shtëpive tradicionale	9
3.14. Promovimi i gastronomisë lokale	9
IV PROMOVIMI I TURIZMIT DHE FORCIMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË NË KOMUNËN E RAHOVECIT	9
4.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor	10
4.2. Realizimi i investimeve kapitale për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore	10
4.3. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit	10
V PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SHKOLLORE DHE VEPRIME QË SYNOJNË RRITJEN E CILËSISË NË ARSIM	11
VI PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE I MIRËQENIES SË QYTETARËVE	12
6.1. Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore	12
6.2. Mbështetje për shëndetin mendor dhe shërbime sociale	12
6.3. Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna	12
6.4. Shërbime të avancuara dhe kujdes paliativ	12

6.5. Parandalimi i sëmundjeve dhe edukimi shëndetësor	13
6.6. Përmirësimi i menaxhimit dhe i kapaciteteve njerëzore	13
6.7. Kujdesi për personat e moshuar dhe angazhimi i vullnetarëve	13
6.8. Menaxhimi i sëmundjeve kronike	13
6.9. Siguria shëndetësore dhe përgatitja për emergjenca	13
VII MBROJTJA E MJEDISIT, PLANIFIKIMI URBAN DHE SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE	13
7.1. Mbrojtja e mjedisit dhe inovacioni digjital	13
7.2. Urbanizimi i qytetit dhe fasadimi i objekteve kolektive dhe individuale	14
7.3. Infrastrukturë e qëndrueshme dhe moderne	14
7.4. Zhvillimi i hapësirave publike dhe përmirësimi i cilësisë së jetës	14
VIII ADMINISTRATË E PËRGJITHSHME	15
IX KULTURA, RINIA DHE SPORTI	15
X KORNIZA FISKALE KOMUNALE.....	16
10.1. Indikatorët ekonomikë komunalë	16
10.2. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2027 - 2029.....	16
10.3. Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afatmesëm 2027 - 2029.....	20
XI ANALIZA GJINORE - BUXHETIMI GJINOR	29

I. HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Rahovecit, që po prezantojmë, është një dokument strategjik i nivelit të lartë komunal, i cili miratohet në parim çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument siguron një analizë të detajuar të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB-i ofron mekanizmat e nevojshëm për realizimin e objektivave dhe të prioritetëve të identifikuar në dokumentet strategjike të Komunës, duke siguruar integrim të plotë në procesin buxhetor.


Kuadri ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore është detyrim për institucionet buxhetore komunale, i përcaktuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2027/01, të lëshuara nga Ministria e Financave, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Në kuadër të avancimit të politikave gjithëpërfshirëse, kjo Kornizë merr në konsideratë edhe parimet dhe kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, duke synuar që planifikimi buxhetor të kontribuojë në mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, si pjesë integrale e politikave sociale dhe zhvillimore të komunës.

Në këtë kontekst, KAB gjithashtu reflekton nevojën për integrimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, duke marrë parasysh se shërbimet publike në nivel lokal veçanërisht në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien dhe zhvillimin e tyre. Përmes planifikimit të qëndrueshëm buxhetor, synohet që këto shërbime të jenë të qasshme, cilësore dhe të orientuara drejt nevojave reale të fëmijëve.

Për më tepër, duke u mbështetur në qasjen e buxhetimit të ndjeshëm ndaj fëmijëve, Komuna synon që në procesin e planifikimit afatmesëm të identifikojë dhe adresojë në mënyrë më të strukturuar nevojat e fëmijëve, veçanërisht atyre në situata të ndjeshme, duke siguruar që politikat dhe programet komunale të kontribuojnë në mbrojtjen dhe përfshirjen e tyre sociale.

Ky dokument shërben si bazë për përcaktimin e sektorëve dhe prioritetëve të zhvillimit, si dhe për identifikimin e mënyrës së shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2027 - 2029. Procesi i zhvillimit të KAB-it përfshin katër (4) faza kryesore me afate të përcaktuara, të cilat ilustrohen në figurat e mëposhtme:



II. STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi dhe pozita gjeografike i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra, 2 vendbanime të vogla dhe një qendër urbane, e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 41,799 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2024, e organizuar në 9,180 ekonomi familjare.

Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, mbi 2,372 biznese operojnë brenda komunës sonë, të cilat kategorizohen, si: Aktivitete shërbyese të pijeve: 11.09 %; Tregti tjetër me pakicë në dyqanet jo të specializuara: 10.29 %; Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani: 9.53 %; Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve: 8.56 %; Tregtia me shumicë, jo e specializuar: 8.22 %; Transporti rrugor i mallrave: 8.56 %; Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore: 7.84 %; Përfundimi dhe finalizim i punëve të tjera të ndërtesave: 6.66 %; Punime suvatimi: 6.91 %; Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit: 6.83 %; Aktivitete të tjera: 15.51 %.

Administrata komunale është e strukturuar nëpërmjet zyrave qendrore dhe lokale, që ofrojnë shërbime direkte për qytetarët. Administrata e komunës aktualisht ka në përdorim 5 (pesë) e-kiosqe për vetëshërbimin qytetar, duke u mundësuar atyre qasje më të lehtë dhe efikase për t'u pajisur me dokumentet e nevojshme administrative.

Pas konsultimeve të gjera me aktorët kyç politikë, ekonomikë dhe shoqërorë, si dhe në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027 - 2029 të Qeverisë së Kosovës dhe Qarkoren Buxhetore Komunale, është përcaktuar një vizion i ri dhe i fokusuar për zhvillimin e Komunës së Rahovecit.

Vizioni i Komunës së Rahovecit 2027 - 2029:

Rahoveci synon të zhvillohet si një komunë model i qëndrueshmërisë, ku bujqësia moderne dhe inovative është shtylla kryesore e ekonomisë lokale. Me urbanizim të planifikuar mirë dhe me infrastrukturë të avancuar, komuna do të ofrojë kushte optimale për jetesë dhe punë, duke ruajtur një mjedis të pastër dhe natyrë të mbrojtur. Investimet në energji të ripërtëritshme dhe eficiente, ku shërbimet cilësore publike dhe teknologjia digjitale do të forcojnë zhvillimin ekonomik dhe social. Rahoveci do të afirmohet si një qendër e kulturës, e arsimit dhe e sportit, duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët dhe duke u integruar fuqishëm në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare.

Atributet kryesore që do të karakterizojnë këtë vizion, janë: komunikimi i hapur, transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje. Për të arritur këtë, prioritetet strategjike të Komunës janë të fokusuara në shtatë (7) prioritete kryesore, të shoqëruara me zotimet përkatëse, të cilat do të sigurojnë realizimin e vizionit dhe të zhvillimit afatmesëm të komunës sonë.

Prioritetet strategjike Afatmesme të Komunës së Rahovecit (2027 - 2029)

Në kuadër të realizimit të vizionit, Komuna e Rahovecit ka identifikuar prioritetet kryesore strategjike për periudhën 2027 - 2029, të cilat përqendrohen në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social, duke i vënë në theks të veçantë sektorët kyç të zhvillimit lokal.

2.1. PRIORITETET

2.1.1. BUJQËSI E QËNDRUESHME DHE MODERNIZIM I SEKTORIT AGRAR

- PËRKRAHJA DHE PROMOVIMI I PRAKTIKAVE BUJQËSORE INOVATIVE DHE TË QËNDRUESHME;
- ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË FERMERËVE DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË PRODHIMIT BUJQËSOR;
- ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS PËR MAGAZINIM, PËRPUNIM DHE TREGTIM TË PRODHIMEVE BUJQËSORE.

2.1.2. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I MJEDISIT

- PËRFORCIMI I MASAVE PËR MBROJTJEN E BURIMEVE NATYRORE, PËRFSHIRË UJËRAT, PYJET DHE TOKËN BUJQËSORE;
- NXITJA DHE PËRKRAHJA E PROJEKTEVE TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME (SOLARE, ME ERË, ETJ.) DHE EFICIENCËS ENERGJETIKE NË OBJEKTET E SEKTORIT PUBLIK DHE PRIVAT;
- MENAXHIMI I DUHUR I MBETURINAVE DHE PROMOVIMI I RICIKLIMIT DHE I VEPRIMEVE PËR REDUKTIMIN E NDOTJES;
- EDUKIMI DHE SENSIBILIZIMI I KOMUNITETIT PËR RUAJTJEN E MJEDISIT DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE.

2.1.3. ZHVILLIMI I AGROTURIZMIT DHE I SEKTORIT TË TURIZMIT RURAL

- PROMOVIMI I PRODUKTEVE LOKALE DHE ZHVILLIMI I RRUGËVE TURISTIKE QË PASUOJNË OFERTËN E AGROTURIZMIT;
- INVESTIMI NË INFRASTRUKTURËN TURISTIKE, PËRFSHIRË AKOMODIMIN, SHËRBIMET DHE AKTIVITETET KULTURORE DHE AMBIENTALE;
- BASHKËPUNIMI ME AKTORË LOKALË DHE NDËRKOMBËTARË PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM DHE RITJEN E VIZITORËVE;
- PËRKRAHJA E SIPËRMARRËSVE NË SEKTORIN E TURIZMIT RURAL DHE OFRIMI I TRAJNIMEVE PËR SHËRBIME CILËSORE.

2.1.4. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PËRKRAHJA E BIZNESEVE LOKALE

- KRIJIMI I KUSHTEVE TË FAVORSHME PËR INVESTIME LOKALE DHE TË HUAJA;
- PËRKRAHJA E BIZNESEVE TË VOGLA DHE TË MESME, VEÇANËRISHT ATYRE NË SEKTORËT AGRARË DHE TURISTIKË;
- ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS PËR BIZNESET DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE TË NEVOJSHME PËR RITJEN E TYRE.

2.1.5. ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE

- INVESTIME NË INFRASTRUKTURË DHE PAJISJE MODERNE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE PËR TË SIGURUAR ARSIM CILËSOR DHE BASHKËKOHOR;
- ZGJERIMI I KAPACITETEVE NË INFRASTRUKTURË TË SHËNDETËSISË PRIMARE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE;
- QASJE MË E LEHTË DHE CILËSORE PËR SHËRBIMET SOCIALE

2.1.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE E QËNDRUESHME DHE SHËRBIMET PËR QYTETARË

- PËRMIRËSIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE, E UJËSJELLËSIT, E KANALIZIMEVE DHE E INFRASTRUKTURËS KOMUNALE;
- ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE CILËSORE DHE EFIKASE, DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJI BASHKËKOHORE;
- ADMINISTRATË EFIKASE QË OFRON SHËRBIME TRANSPARENTE, TË SHPEJTA DHE ME CILËSI TË LARTË.

2.1.7. PROMOVIMI I KULTURËS, PËRKRAHJE PËR TË RINJTË, PROMOVIMI I TRASHËGIMISË DHE I VLERAVE TONA

- MBROJTJA DHE PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE DHE HISTORIKE;
- MBËSHËTETJA E AKTIVITETEVE KULTURORE, SPORTIVE DHE RINORE QË FORCOJNË IDENTITETIN TONË;
- ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR NË FUSHAT E KULTURËS DHE TË SPORTIT.

2.2. ZOTIMET

- KOMUNË E HAPUR, ME PERFORMANCË TË LARTË DHE TRANSPARENTE NDAJ QYTETARËVE, KU INFORMACIONI ËSHTË I QASSHËM DHE LLOGARIDHËNIA ËSHTË STANDARD I PANDRYSHUESHËM;
- QEVERISJE E DREJTË, LIGJORE DHE EFEKTIVE, QË RESPEKTON LIGJIN DHE SYNON REZULTATE TË QËNDRUESHME PËR QYTETARË;

- SHËRBIME PUBLIKE GJITHPËRFSHIRËSE, CILËSORE DHE TË BARABARTA PËR TË GJITHË QYTETARËT, PA ASNJË FORMË DISKRIMINIMI;
- PROMOVIM I QEVERISJES MODERNE DHE I STANDARDEVE TË LARTA ADMINISTRATIVE, ME FOKUS NË EFIKASITET DHE SHPEJTËSI NË SHËRBIME;
- PËRKUSHTIM PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E MJEDISIT NATYROR, DUKE ZHVILLUAR POLITIKA DHE PROJEKTE QË NXISIN MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË BURIMEVE DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË JETËS;
- ZHVILLIM I QËNDRUESHËM I BUJQËSISË DHE I AGROTURIZMIT, ME MBËSHTETJE PËR FERMERËT DHE SIPËRMARRJET LOKALE QË KRIJOJNË VENDE PUNE DHE RRISIN POTENCIALIN EKONOMIK;
- RUAJTJE DHE PROMOVIM I TRASHËGIMISË KULTURORE, HISTORIKE DHE NATYRORE, SI ELEMENT KYÇ I IDENTITETIT DHE ZHVILLIMIT SOCIAL;
- RESPEKT I PALËKUNDUR PËR TË DREJTAT DHE DINJITETIN E ÇDO QYTETARI, DUKE KRIJUAR NJË AMBIENT TË PËRFSHIRJES, TË TOLERANCËS DHE TË BASHKËJETESËS;
- PËRKUJDESJE E VEÇANTË PËR QYTETARËT ME NEVOJA TË VEÇANTA, DUKE SIGURUAR MBËSHTETJE DHE MUNDËSI TË BARABARTA PËR TË GJITHË;
- PJESËMARRJE AKTIVE E QYTETARËVE NË PROCESET VENDIMMARRËSE, PËR TË GARANTUAR QË ZHVILLIMI I KOMUNËS TË JETË NË SHËRBIM TË INTERESAVE REALE TË QYTETARËVE;
- BASHKËPUNIM I NGUSHTË ME SEKTORIN PRIVAT, ORGANIZATAT JOQEVERITARE DHE KOMUNITETET LOKALE, PËR TË NDËRTUAR NJË EKOSISTEM ZHVILLIMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE TË QËNDRUESHËM;
- INVESTIM NË EDUKIM, SHËNDETËSI DHE INFRASTRUKTURË SOCIALE, PËR TË PËRMIRËSUAR CILËSINË E JETËS DHE MIRËQENIEN E PËRGJITHSHME;
- TREFISHIM I BUXHETIT PËR PËRKRAHJEN E BIZNESEVE TË REJA (START UP);
- SUBVENCIONIMI I FËMIJËVE NË ÇERDHET PUBLIKE.

2.3. SYNIMET

- HARTIMI DHE ZBATIMI I PLANEVE RREGULLUESE URBANE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM DHE MENAXHIM TË HAPËSIRAVE PUBLIKE;
- MBROJTJA DHE PËRMIRËSIMI I MJEDISIT PËRMES MENAXHIMIT TË MBETURINAVE, TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA DHE PROJEKTEVE TË GJELBRA;
- MBËSHTETJE E BUJQËSISË SË QËNDRUESHME PËRMES INVESTIMEVE NË TEKNOLOGJI, TRAJNIME DHE INFRASTRUKTURË RURALE;
- MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, I RRUGËVE DHE I LIDHJEVE MË TË MIRA NDËRMJET ZONAVE URBANE DHE RURALE;
- PROJEKTE PËR NGRITJEN E CILËSISË NË ARSIM PËRMES INVESTIMEVE NË SHKOLLA, PAJISJE, TEKNOLOGJI, TRAJNIM TË MËSIMDHËNËSVE DHE QASJE TË BARABARTË PËR NXËNËSIT;

- PROMOVIMI DHE ZHVILLIMI I KULTURËS DHE I AKTIVITETEVE SPORTIVE;
- PROJEKTE QË ZGJEROJNË SHËRBIMET, AVANCOJNË CILËSINË E TYRE, SI DHE PROJEKTE TË KUJDESHIT SOCIAL PËR TË GJITHË QYTETARËT.

III. FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Qeverisja jonë do të ndërtojë një ekosistem ekonomik gjithëpërfshirës që mbështet të gjitha kategoritë e biznesit, nxit zhvillimin rural, promovon inovacionin dhe përmirëson mirëqenien e qytetarëve, duke ruajtur mjedisin dhe pasuritë kulturore.

3.1. Zhvillimi i agroturizmit dhe i turizmit rural

- Promovim i fshatrave me potencial turistik përmes: vizitave në fermat lokale, degustime të produkteve tradicionale (verë, fruta, produkte blegtorale) dhe aktivitete kulturore;
- Mbështetje për ngritjen e shtëpive mikpritëse (home stay) dhe organizimi i ngjarjeve tradicionale dhe festivaleve sezonale për të tërhequr turistë vendorë dhe të huaj.

3.2. Investime në infrastrukturë turistike dhe mjedisore

- Mirëmbajtja e shtigjeve për ecje, rrugëve rurale dhe pikave rekreative për sporte natyre, si: çiklizmi, ecje malore dhe shëtitje;
- Përmirësim i shërbimeve në zonat turistike: ndriçim, tabela informative dhe vende pushimi.

3.3. Promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe organike

- Mbështetje për fermerët që përdorin praktika organike dhe të qëndrueshme përmes subvencioneve, trajnimeve dhe qasjes në tregje lokale dhe rajonale;
- Nxitje e kooperativave bujqësore për fuqizim në marketing dhe shitje.

3.4. Zhvillimi i infrastrukturës bazë për bujqësinë dhe për mjedisin

- Përmirësim i sistemeve të ujitjes dhe i trajtimit të ujërave, me fokus në kursimin e ujit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore;
- Investime në menaxhimin e mbeturinave dhe promovim i riciklimit në nivel komunal.

3.5. Fuqizimi i kapaciteteve lokale dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

- Organizim i trajnimeve për fermerë, sipërmarrës dhe të rinj në teknologji, marketing dhe menaxhim të qëndrueshëm;
- Përfshirje e komunitetit në aktivitete ekologjike dhe edukim mjedisor në shkolla dhe në hapësira publike.

3.6. Nxitja e turizmit kulturor dhe e trashëgimisë lokale

- Restaurim dhe promovim i monumenteve historike dhe kulturorë të Rahovecit dhe të zonave përreth;
- Organizim festivalesh kulturore, panaire artizanale dhe ngjarje që forcojnë identitetin lokal.

3.7. Lehtësimi i procedurave për investime dhe ndërmarrësi

- Modernizim i shërbimeve administrative për bizneset dhe qytetarët, me platforma digjitale për transparencë dhe lehtësim;
- Konsulencë falas dhe asistencë për aplikime në projekte zhvillimore dhe fonde evropiane.

3.8. Parku ekoturistik dhe edukativ

- Krijimi i një parku natyror me shtigje edukative dhe pika informuese mbi florën dhe faunën lokale, me aktivitete për fëmijë, nxënës dhe familje, për të rritur ndërgjegjësimin ekologjik dhe turizmin.

3.9. Tregu i produkteve lokale dhe ekologjike

- Organizimi i tregjeve javore ose mujore ku fermerët dhe artizanët vendas shesin produkte autentike, organike dhe artizanale, duke e kthyer tregun në një atraksion për banorë dhe turistë.

3.10. Festivali i verës dhe i kulturës së Rahovecit

Ngjarje (vjetore) me koncerte, ekspozita artizanale, gara sportive dhe kuzhinë lokale që promovojnë trashëgiminë kulturore dhe tërheqin vizitorë nga rajoni dhe më gjerë.

3.11. Zhvillimi i infrastrukturës për sportet ekstreme dhe rekreative

- Investime në fusha për biçikletë malore, vrapim dhe sporte të tjera aktive, duke rritur turizmin rinor dhe aktiv.

3.12. Iniciativa për përdorimin e energjive të rinovueshme

- Projekte pilot për instalimin e paneleve diellore në ndërtesa publike dhe fermat e mëdha, për uljen e kostove dhe promovimin e qëndrueshmërisë energjetike.

3.13. Programi për rinovimin dhe rregullimin e shtëpive tradicionale

- Mbështetje për restaurimin e shtëpive tradicionale, duke i kthyer ato në pika referimi të turizmit rural dhe kulturor, përmes subvencioneve dhe trajnimeve për artizanët lokalë.

3.14. Promovimi i gastronomisë lokale

- Organizim i kurseve dhe i punëtorive (work shop-eve) për gatime tradicionale dhe produkte autentike si përvojë turistike.

IV. PROMOVIMI I TURIZMIT DHE FORCIMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Ky seksion përfshin prioritetet strategjike dhe ndarjet buxhetore për vitin 2027 në sektorin e bujqësisë, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Rural të Ministrisë së Bujqësisë për periudhën 2022–2027.

Prioritetet kryesore për këtë periudhë janë:

- Zbatimi i projekteve që mbështesin drejtpërdrejt fermerët dhe rrisin produktivitetin e tyre;
- Realizimi i investimeve kapitale për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore;

- Zhvillimi i turizmit rural dhe i agroturizmit si nxitës i zhvillimit ekonomik lokal dhe krijimit të vendeve të punës.

4.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor

Perimekulturë, pemëtari dhe vreshtari

- Përkrahje fermerëve me farëra;
- Plehra kimike;
- Inpute bujqësore;
- Preparate për trajtim të sëmundjeve;
- Mbështetje për fermat multifunkionale që ofrojnë prodhim, përpunim, shitje dhe turizëm në të njëjtin vend;
- Investime në sipërfaqe të mbrojtura – serra;
- Përkrahja e bujqve për ngritje të fidanishteve për prodhim të fidanëve cilësorë;
- Sektori i blegtorisë - shërbime veterinarë (vaksinimi, kontrollimi i kafshëve, ripelimi etj.);
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre;
- Sektori i bletarisë – furnizim me ushqim për bletë;
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe të perimeve;
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit;
- Këshillimi i fermerëve dhe marrja përsipër e përgatitjes së të gjitha dokumenteve dhe planeve të biznesit për aplikim në institucione të ndryshme, duke angazhuar ekspertë.

4.2. Realizimi i investimeve kapitale për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore

- Ndërtimi i rrugëve fushore, me theks të veçantë mirëmbajtja e tyre;
- Ndërtimi i kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet që rrezikojnë tokat bujqësore;
- Pastrimi dhe zgjerimi i përrenjve që krijojnë probleme të vazhdueshme për fermerë;
- Mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi – erozioni;
- Drenazhimi i tokave bujqësore;
- Përkrahje për praktika bujqësore të qëndrueshme dhe mbrojtjen e tokës;
- Investime në ujitje moderne dhe përdorim racional të ujit, me theks të veçantë në sistemin e ujitjes pikë-pikë.

4.3. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit

Në përputhje me shtyllën III të Strategjisë së Zhvillimit Rural 2022–2027, që synon diversifikimin ekonomik në zonat rurale dhe zhvillimin e aktiviteteve jobujqësore, Komuna e Rahovecit do të fokusohet në zhvillimin e agroturizmit si mundësi për: Rritjen e të ardhurave të fermerëve; Ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore; Përmirësimin e mirëqenies në zona rurale.

4.3.1. Investimet kryesore

- Mbështetje për modernizimin dhe përmirësimin e kapaciteteve akomoduese në fermat agroturistike;
- Trajnime për standarde mikpritjeje dhe shërbime turistike cilësore;
- Integrim të turizmit me gastronominë lokale dhe produktet tradicionale;

- Bashkëpunim me agjencitë turistike dhe institucionet arsimore për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

4.3.2. Mbështetje direkte për prodhimin bujqësor dhe agropërpunimin

- Subvencione për inpute bujqësore dhe teknologji inovative;
- Përkrahje për prodhimin primar dhe certifikimin e produkteve lokale (BIO, PGI etj.).

4.3.3. Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe i inovacionit

- Trajnime për fermerë, gratë dhe të rinjtë në teknologji dhe marketing;
- Bashkëpunim me institucione arsimore dhe me qendra këshilluese.

4.3.4. Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore

- Përkrahje për praktika bujqësore ekologjike dhe mbrojtje të tokës;
- Investime në sisteme moderne të ujitjes, veçanërisht teknologjinë “pikë-pikë”;
- Investime në sisteme moderne të spërkatjes në sektorin e vreshtarisë me dron.

4.3.5. Agroturizmi si prioritet për diversifikim rural

- Zhvillimi i fermave mikpritëse për ofrimin e eksperiencave bujqësore autentike;
- Krijimi i skemave për investime në infrastrukturë agroturistike;
- Promovim i produkteve dhe i përvojave përmes marketingut dhe platformave digjitale.

V. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SHKOLLORE DHE VEPRIME QË SYNOJNË RITJEN E CILËSISË NË ARSIM

- Rivlerësim i nevojave për objektet shkollore në qytet dhe në fshatra, me investime për riparime apo ndërtim të shkollave fillore dhe të mesme sipas nevojës;
- Përmirësim i kushteve infrastrukturore të shkollave për të rritur cilësinë e arsimit;
- Masat për eficiencë energjetike në shkolla, duke aplikuar për fonde nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
- Investime në pajisje laboratorike, teknologji informative, tabela digjitale dhe furnizim me libra për bibliotekat shkollore;
- Digjitalizim dhe vizualizim i materialeve mësimore për nxënësit nga parashkollorja deri në klasën e nëntë;
- Bashkëpunim i përhershëm midis organeve drejtuese të shkollave, këshillave të prindërve dhe nxënësve;
- Angazhim i psikologëve dhe i pedagogëve për mbështetje profesionale në shkolla;
- Ofrim i trajnimeve profesionale për mësimdhënësit, me fokus te mësimdhënësit fillestarë;
- Monitorim i vazhdueshëm i procesit edukativo-arsimor nga ekipi i DKA-së;
- Funksionalizim i plotë i çerdhes së re në qytet, planifikuar për përfundim në vitin 2025;
- Organizim i garave periodike të diturisë për nxënës të të gjitha niveleve;
- Monitorim i përdorimit të pakos pedagogjike në shkolla;
- Vazhdim i funksionimit të qendrave arsimore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për edukim shitesë;
- Vazhdim i funksionimit të qendrave të karrierës në shkollat profesionale “Xhelal Hajda-Toni” dhe “Selajdin Mullabazi – Mici”;
- Bursa për studentë dhe nxënës, përkrahje për profesionistët që na përfaqësojnë me sukses;

- Edukim dhe përkrahje për nxënësit me nevoja të veçanta, duke ofruar transport dhe kushte të përshtatura për mësim;
- Organizim i vizitave shëndetësore sistematike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF-në.

VI. PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE I MIRËQENIES SË QYTETARËVE

Qëllimi kryesor: Të ofrohet kujdes shëndetësor cilësor, i qasshëm për të gjithë qytetarët, duke përmirësuar kapacitetet institucionale dhe duke rritur mirëqenien sociale dhe shëndetësore.

6.1. Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore

- Caktimi i mjekut familjar për çdo qytetar, për të siguruar kujdes të vazhdueshëm dhe të personalizuar;
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore mobile për zonat rurale dhe më të largëta, që qytetarët të kenë qasje më të lehtë;
- Sigurimi i barnave esenciale për të gjithë qytetarët, me subvencionim të barnave për personat me të ardhura të ulëta.

6.2. Mbështetje për shëndetin mendor dhe shërbime sociale

- Angazhimi i ekipeve multidisciplinare (mjekë familjarë, psikologë, punëtorë socialë, logopedë) për trajtim dhe mbështetje të shëndetit mendor;
- Bashkëpunim i ngushtë me Qendrën Rajonale të Shëndetit Mendor në Gjakovë për koordinim dhe referim të rasteve;
- Zhvillimi i programeve për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve mendore, me përfshirje të komunitetit dhe të familjeve;
- Ofrimi i këshillimeve dhe trajtimeve për persona në nevojë, përfshirë ndihmën në situata emergjente dhe për sëmundje terminale.

6.3. Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna

- Shërbime mjekësore të rregullta në çerdhe dhe kopshte, për monitorimin e shëndetit të fëmijëve 0-6 vjeç;
- Organizim i vizitave sistematike shëndetësore në shkollë për nxënësit;
- Krijimi i klasave edukative për shtatzëna në njësinë e maternitetit, me ofrim të informacioneve dhe të këshillave shëndetësore.

6.4. Shërbime të avancuara dhe kujdes paliativ

- Zhvillimi i kujdesit paliativ dhe shtëpiak për pacientët me sëmundje kronike dhe terminale;
- Zgjerimi i shërbimeve laboratorike në QKMF, duke përfshirë analiza të ndryshme dhe teste diagnostikuese;
- Ofrimi i shërbimeve këshilluese për pacientët me sëmundje kronike dhe edukim për menaxhimin e sëmundjeve;
- Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i rregullt i të gjitha objekteve shëndetësore, objekteve arsimore, objekteve të tjera publike, si dhe i hapësirave publike.

6.5. Parandalimi i sëmundjeve dhe edukimi shëndetësor

- Organizimi i fushatave të rregullta për vaksinim dhe parandalim të sëmundjeve ngjitëse;
- Promovimi i stilit të shëndetshëm të jetesës përmes aktiviteteve edukative në shkolla dhe institucione të tjera edukative;
- Funksionalizimi i dhomave për edukim dhe promovim shëndetësor në QKMF dhe qendrat shëndetësore në fshatra.

6.6. Përmirësimi i menaxhimit dhe i kapaciteteve njerëzore

- Rritja e numrit të personelit shëndetësor në të gjitha nivelet, duke përfshirë infermierë, mjekë, psikologë dhe punonjës socialë;
- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për stafin shëndetësor për përmirësimin e shërbimeve;
- Krijimi i sistemeve të monitorimit të cilësisë dhe të performancës së shërbimeve shëndetësore në nivel lokal;
- Investime në teknologji informative për menaxhimin e shërbimeve dhe të dhënave shëndetësore.

6.7. Kujdesi për personat e moshuar dhe angazhimi i vullnetarëve

- Shërbime mobile dhe monitorim i shëndetit për personat e moshuar;
- Organizimi i aktiviteteve sociale dhe edukative për përmirësimin e mirëqenies psikologjike.

6.8. Menaxhimi i sëmundjeve kronike

- Sisteme monitorimi dhe trajnime për menaxhimin e diabetit, hipertensionit dhe sëmundjeve kardiovaskulare.

6.9. Siguria shëndetësore dhe përgatitja për emergjencë

- Trajnime për menaxhimin e emergjencave shëndetësore;
- Krijimi i planeve për situata krizash dhe furnizimi me pajisje të duhura emergjence;
- Hapësira për karantinë, në rast nevojë.

VII. MBROJTJA E MJEDISIT, PLANIFIKIMI URBAN DHE SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE

7.1. Mbrojtja e mjedisit dhe inovacioni digjital

- **Platforma digjitale për raportimin e ndryshimeve në mjedis dhe ndotjes** - Krijimi i një aplikacioni apo portali online ku qytetarët mund të raportojnë në kohë reale ndotjen, shkeljet e mjedisit apo probleme të tjera, duke përfshirë foto dhe pozicion gjeografik. Inspektorët komunalë do të marrin njoftime automatike për ndërhyrje të shpejta.
- **Edukimi dhe përfshirja e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit** - Programi “Qyteti ynë, ambienti ynë” që përfshin fushata ndërgjegjësuëse, gara dhe aksione për pastrimin e lagjeve dhe shpërblime për kontribute konkrete në mbrojtjen e ambientit.

7.2. Urbanizimi i qytetit dhe fasadimi i objekteve kolektive dhe individuale

- **Fasadimi i objekteve të banimit kolektiv me materiale bashkëkohore dhe me eficiencë të qëndrueshme të energjisë** - Organizimi i një programi subvencionues për banorët dhe pronarët e ndërtesave kolektive, ku ndihmohet me materiale izolimi, panele diellore dhe dizajn modern të fasadave, për një pamje estetike dhe kursim energjie.
- **Shëtitore dhe hapësira multifunkionale në zonat kryesore të qytetit** - Krijimi i zonave pa trafik automjesh në sheshin qendror dhe rrugët pranë tij, të pajisura me elemente të gjelbërimit, pajisje urbane funksionale (stola, pika karikimi për biçikleta elektrike) dhe hapësira për aktivitete kulturore e tregtare.
- **Rikualifikimi i lagjeve të vjetra me arkitekturë moderne dhe ekologjike** - Përfshirja në projektet e planifikimit urban të praktikave që përfshijnë hapësira të gjelbra, rrugë të përshtatshme për këmbësorë dhe biçiklistë, zona lojërash për fëmijë dhe ndriçim me teknologji led.

7.3. Infrastrukturë e qëndrueshme dhe moderne

- **Rrjeti i biçikletave dhe i transportit alternativ** - Zgjerimi i shtigjeve të biçikletave në zonat urbane dhe periferike, me pika të sigurta parkimi dhe stacione karikimi për biçikleta elektrike dhe skuterë elektrikë, si alternativë ndaj makinave;
- **Smart lighting – Ndriçim publik i mençur** - Implementimi i sistemit të ndriçimit publik inteligjent që përshtatet me lëvizjen e njerëzve dhe të automjeteve, me qëllim kursimi energjie;
- **Bashkëpunim me KEDS-in për furnizim të stabilizuar me energji elektrike** - Përmirësim i rrjetit elektrik me ndërrim të shtyllave, instalime nëntokësore dhe përdorim të teknologjive inteligjente për monitorim dhe mirëmbajtje;
- **Bashkëpunim me K.R.U. “Gjakova” dhe me partnerë për ujë të pijshëm cilësor** - Projekte për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, me investime dhe mbështetje nga donatorë për rrjetin e ujësjellësit;
- **Trajtimi i ujërave të zeza dhe i ujërave atmosferike** - Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të kolektorëve dhe impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në zonat urbane dhe rurale, si dhe sistemet e përthithjes dhe të largimit të ujërave atmosferike për parandalimin e përmytjeve;
- **Investime në asfaltimin dhe riasfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatra**: rruga Rahovec – Drenoc, Senoc, Patasel, Polluzhë, rruga Drenoc – Pataqan i Epërm – Pataqan i Poshtëm – Fortesë dhe rruga Fortesë – Celinë. Gjithashtu, riasfaltimi i rrugëve urbane dhe trajtimi i infrastrukturës për ujëra atmosferike dhe fekale;
- **Përmirësimi i infrastrukturës për persona me nevojë të veçanta** - Adaptimi i rrugëve, i trotuareve, ndërtesave dhe hapësirave publike për qasje sa më të lehtë dhe të sigurt për personat me aftësi të kufizuara.

7.4. Zhvillimi i hapësirave publike dhe përmirësimi i cilësisë së jetës

- **Parku qendror multifunksional dhe Ballkoni panoramik** - Ndërtimi i parkut të qytetit me zona të gjelbra, pista për vrapim dhe biçikleta, kënde lojërash, hapësira për aktivitete kulturore dhe ballkoni panoramik me pamje unike të qytetit;
- **Hapësira për edukim dhe ndërgjegjësim ambiental në QKMF dhe shkolla** - Krijimi i dhomave dhe i qendrave për edukim ekologjik dhe promovim të shëndetit, ku qytetarët dhe nxënësit mund të mësojnë rreth riciklit, kursimit të energjisë dhe kujdesit ndaj mjedisit;

- **Wi-Fi falas në hapësirat publike dhe pikat kryesore të qytetit** - Për të rritur lidhjen digjitale dhe qasjen në informacion, duke krijuar mundësi lidhjeje më të mira me shërbime interneti dhe përditësim me zhvillimet urbane dhe ambientale.

VIII. ADMINISTRATË E PËRGJITHSHME

- Avancimi i mëtejshëm drejt një administrate digjitale, transparente dhe efikase, që u shërben qytetarëve me shpejtësi;
- Votim elektronik në Kuvendin Komunal për efikasitet dhe pjesëmarrje demokratike;
- Digjitalizim i dokumentacionit për menaxhim më të lehtë dhe më të sigurt;
- E-kiosqet, shërbime të reja, të shpejta dhe të kombinuara;
- Sportele të veçanta për mërgatën;
- Adaptim i shërbimeve dhe i ambienteve për personat me nevojë të veçanta;
- Vendosje kamerash për siguri në pika kyçe publike;
- Furnizim me teknologji moderne dhe trajnime për staf, për administratë më profesionale dhe bashkëkohore;
- Digjitalizim i sallës së mbledhjeve;
- Riorganizim i objekteve dhe i mjediseve në administratën komunale.

IX. KULTURA, RINIA DHE SPORTI

- Përfundimi i punimeve dhe funksionalizimi i Qendrës për Art, Kulturë dhe Inovacion, një hapësirë multifunkionale për ngjarje artistike, trajnime dhe iniciativat e të rinjve;
- Ndërtimi i fushave sportive moderne me standarde UEFA, stadiumi në Rahovec dhe vazhdimi i ndërtimit të terreneve sportive nëpër fshatra e vendbanime ku është e nevojshme;
- Kujdesi i vazhdueshëm për objektet e trashëgimisë kulturore, përfshirja e tyre në listën e monumenteve nën përkujdesje institucionale, si dhe restaurimi dhe mirëmbajtja e muzeve, komplekseve përkujtimore, busteve dhe përmendoreve të dëshmorëve;
- Funksionalizimi i ansamblit profesional të këngëve dhe valleve të Rahovecit dhe përkrahje për festivalet dhe ngjarjet kulturore dhe sportive tradicionale dhe rinore;
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat komunale dhe organizimi i fushatave për nxitjen e leximit;
- Mbështetje konkrete për ide kreative dhe artistike të rinisë, përfshirë promovimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e kulturës dhe të sportit;
- Programi “Ambasadorët e trashëgimisë kulturore” për nxënësit, përfshirja aktive në ruajtjen dhe promovimin e monumenteve historike dhe organizimi i tureve dhe aktiviteteve multimediale;
- Programi “Sporti për të gjithë”, që përfshin aktivitete sportive për grupet me nevojë të veçanta dhe të moshuarit, që është më gjithëpërfshirës;
- Fushata për promovimin e leximit “Libri në çdo dorë” me takime me autorë, shfaqje teatrore dhe shpërndarje librash falas;
- Realizimi i projekteve muralistike dhe “Street art” në hapësira publike për të promovuar dhe shfaqur në mënyrë artistike identitetin tonë dhe për të zbukuruar qytetin;

- Programi vjetor “Kampionët e rinisë” për shpërblimin dhe promovimin e të rinjve me arritje në sport dhe në kulturë;
- Përmbyllja e punimeve në kompleksin sportiv tek “Epopeja e UÇK-së”, si dhe plan i hollësishëm për ndërtimin e hapësirave të reja sportive, rekreative dhe kulturore.

X. KORNIZA FISKALE KOMUNALE

10.1. Indikatorët ekonomikë komunalë

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me Kornizën Makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2027 - 2029, përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike, siç janë: Bruto-produkti vendor, inflacioni dhe demografia, duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2027 - 2029 e Qeverisë së Kosovës, bazuar në të dhënat historike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Komuna, nga ana e saj, do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe të rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht të rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht, financimi komunal përfshin: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grantet qeveritare.** Komunitat, po ashtu, janë pranuese të granteve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes, sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Rahovecit, në periudhën afatmesme buxhetore 2027 - 2029, nëse krijohen rrethanat, mund të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e ujërave të zeza, eventualisht ndonjë projekt tjetër me rëndësi strategjike për komunën tonë, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

10.2. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2027 - 2029

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – Granti qeveritar, si dhe të hyrat vetanake komunale, kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Situata ekonomike në nivel komunal vlerësohet në mënyrë të rregullt për të reflektuar zhvillimet dhe kapacitetet fiskale të komunës në ofrimin e shërbimeve publike dhe realizimin e investimeve kapitale. Indikatorët ekonomikë kryesorë që ndikojnë në planifikimin buxhetor, përfshijnë: normën e papunësisë, nivelin e të ardhurave për kokë banori, zhvillimin e sektorit privat, kapacitetin prodhues lokal, si dhe nivelin e inkasimit të të hyrave vetanake.


Gjatë viteve të fundit, Komuna ka shënuar një trend pozitiv në rritjen e të hyrave komunale, duke reflektuar një përmirësim të administrimit fiskal, rritje të aktivitetit ekonomik lokal dhe zgjerim të bazës tatimore. Krahësuar me periudhat paraprake, janë evidentuar këto zhvillime:

- Rritje e të hyrave nga tatimi në pronë si rezultat i përditësimit të regjistrit të pronës dhe të intensifikimit të mbledhjes;
- Zgjerim i të hyrave nga lejet ndërtimore dhe shfrytëzimi i pasurisë komunale si tregues i rritjes së investimeve private;
- Përmirësim i inkasimit nga taksat komunale dhe shërbimet publike, përfshirë pagesat për shërbime administrative dhe urbane;
- Zbatimi i reformave të brendshme në menaxhimin e të hyrave dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe të transparencës.

Ky trend në rritje i të hyrave vetanake, jo vetëm që e forcon autonominë fiskale të Komunës, por gjithashtu krijon hapësirë për planifikim më të qëndrueshëm buxhetor dhe për realizimin e projekteve zhvillimore që reflektojnë prioritetet e komunitetit lokal.

Në projeksionin afatmesëm, parashikohet që të hyrat komunale të vazhdojnë të rriten në përputhje me trendin aktual, duke u mbështetur në faktorë, si: digjitalizimi i shërbimeve, rritja e transparencës fiskale dhe përfshirja më e gjerë e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Prandaj, projeksionet tona për periudhën afatmesme për të hyrat komunale vetanake, do të jenë në trendin rritës përafërsisht 4 milionë €.

Paraqitja grafike 1: Buxheti total i Komunës në vitet 2027 – 2029, milion euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2026, grantet qeveritare për Komunën e Rahovecit, si tërësi së bashku me të hyrat vetanake, do të shënojnë rritje në vitin 2027. Rritja e grantit qeveritar do të jetë **0.42 %** në vitin 2027, në krahasim me 2026, po ashtu, të hyrat vetanake në vitin 2027 do të kenë një rritje prej **3.35 %** në krahasim me vitin 2026.

Tabela 1: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2027 - 2029, në euro

Burimi i të hyrave	2026	2027	2028	2029
Plani	2,251,414.00	2,326,871.00	2,407,673.00	2,540,494.00
Buxhet dhe Financa	1,119,432.00	1,146,089.00	1,158,291.00	1,194,426.00
Tatimi në Pronë	622,731.00	667,879.00	674,558.00	677,931.00
Taksa nga mbeturina	200,000.00	148,602.00	148,177.00	173,673.00
Tatimi në tokë	156,701.00	189,608.00	190,556.00	191,509.00
Taksat rrugore	140,000.00	140,000.00	145,000.00	151,313.00
Administrata dhe Personeli	120,000.00	120,000.00	123,000.00	125,000.00
Taksa - certifikatat e lindjes	15,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00
Taksa - certifikatat e kurorëzimit	9,000.00	9,000.00	9,000.00	9,000.00
Taksa - certifikatat e vdekjes	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Taksa - certifikatat e tjera ofiçarie	46,000.00	46,000.00	47,000.00	48,000.00
Taksa - për pjesëmarrje në tender	0.00	0.00	0.00	0.00
Taksa - për verifikimin e dokumenteve	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Taksa të tjera administrative	44,000.00	44,000.00	46,000.00	47,000.00
Inspeksioni	56,400.00	56,400.00	57,714.00	71,400.00
Taksa të tjera administrative	400.00	400.00	400.00	400.00
Gjobat nga inspektorati	55,000.00	55,000.00	56,314.00	70,000.00
Licencë për pranimin e lokalit	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Inspektimi higjienik dhe sanitar	-	-	-	-
Shërbimet Publike	292,714.00	292,714.00	333,000.00	385,000.00
Taksa për leje-gërmime	1,700.00	1,700.00	1,700.00	1,700.00
Të hyrat nga shitja e mbeturinave	1,500.00	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Shfrytëzimi i pronës publike	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	7,714.00	7,714.00	8,000.00	5,000.00
Qiraja nga objektet publike	4,500.00	4,500.00	4,500.00	3,500.00
Licenca të lira individuale	600.00	600.00	600.00	600.00
Largimi dhe deponimi i automjeteve	700.00	700.00	700.00	700.00
Të hyrat nga gjykatat	54,000.00	54,000.00	64,000.00	70,000.00
Të hyrat nga gjobat e trafikut	220,000.00	220,000.00	250,000.00	300,000.00

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	52,700.00	101,500.00	108,500.00	116,500.00
Taksa të tjera administrative	700.00	700.00	700.00	700.00
Taksa - të hyrat nga pyjet	800.00	800.00	800.00	800.00
Shfrytëzimi i pronës publike (qiraja e tokës bujqësore)	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Participimet në bujqësi	45,000.00	45,000.00	52,000.00	60,000.00
Taksa për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	1,200.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Ekonomia dhe Zhvillimi	281,700.00	281,700.00	295,700.00	295,700.00
Licenca të lira individuale				
Licenca për shërbime profesionale	200.00	200.00	200.00	200.00
Taksë për ushtrimin e veprimtarisë	135,000.00	135,000.00	145,000.00	145,000.00
Licenca të tjera për afarizëm	500.00	500.00	500.00	500.00
Qiraja nga vendosja e objektit tregtar	146,000.00	146,000.00	150,000.00	150,000.00
Kadastra dhe Gjeodezia	87,268.00	87,268.00	77,268.00	82,268.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	36,000.00	36,000.00	32,268.00	32,268.00
Taksa e tjera administrative	3,000.00	3,000.00	3,000.00	3,000.00
Taksa për fl. posed. dhe kopje plani	16,268.00	16,268.00	15,000.00	20,000.00
Taksa për matjen e tokës në terren	32,000.00	32,000.00	27,000.00	27,000.00
Urbanizmi	85,500.00	85,500.00	88,500.00	101,500.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	50,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Taksa të tjera administrative	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00
Taksa për demolim	1,500.00	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Taksa për legalizimin e objekteve	12,000.00	12,000.00	15,000.00	15,000.00
Inspektimi - respektimi i planit urbanistik	3,000.00	3,000.00	3,000.00	3,000.00
Leje mjedisore komunale	12,000.00	12,000.00	12,000.00	25,000.00
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	74,700.00	74,700.00	74,700.00	74,700.00
Participimi nga shëndetësia	70,000.00	70,000.00	70,000.00	70,000.00
Taksa të tjera administrative	700.00	700.00	700.00	700.00
Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Kulturë, Rini, Sport	5,000.00	5,000.00	5,000.00	8,000.00
Shitja e shërbimeve (biblioteka)	5,000.00	5,000.00	5,000.00	8,000.00
Arsim dhe Shkencë	76,000.00	76,000.00	86,000.00	86,000.00
Participimet - çerdhja e fëmijëve	70,000.00	70,000.00	80,000.00	80,000.00
Participimi në arsim	6,000.00	6,000.00	6,000.00	6,000.00

10.2.1. Donatorët e jashtëm (ndërkombëtar)

Financimi nga donatorët e jashtëm gjatë vitit 2027 - 2029, presim që të kemi donacione, dhe financim nga performanca.

10.2.2. Politikat e reja

Regjistrimi i popullsisë i vitit 2024 ka prodhuar efekte të dukshme në ndarjen e burimeve financiare për komunën tonë. Sipas të dhënave preliminare të publikuara nga ASK-ja, është evidentuar një zvogëlim i numrit të përgjithshëm të popullsisë krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo rënie ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e buxhetit të ndarë për komunën tonë nga grantet qeveritare, të cilat bazohen në kritere, si: numri i banorëve, sipërfaqja territoriale, performanca fiskale dhe faktorë të tjerë socio-ekonomikë. Reduktimi i buxhetit si pasojë e regjistrimit, paraqet sfida shtesë për planifikimin dhe realizimin e objektivave afatmesme zhvillimore, sidomos në sektorë, si: arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale dhe investimet kapitale.

Granti specifik për arsim për vitin 2026 ka pësuar ulje në krahasim me vitin paraprak, si rezultat i drejtpërdrejtë i rënies së numrit të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit, në përputhje me të dhënat e fundit zyrtare të regjistrimit të popullsisë. Ky grant shpërndahet në bazë të formulës standarde të aplikuar nga niveli qendror, ku numri i nxënësve përbën komponentin themelor për llogaritjen e shumës së financimit. Si rrjedhojë, çdo ndryshim demografik në popullsinë shkollore reflektohet në mënyrë proporcionale në grantin e ndarë për arsim.

Në të njëjtën mënyrë, edhe granti specifik për shëndetësi ka shënuar rënie, për shkak të uljes së numrit të përgjithshëm të banorëve dhe të rishikimit të strukturës demografike, që janë elemente përbërëse të formulës për ndarjen e këtij granti. Kjo ndikon në financimin e shërbimeve të kujdesit parësor, përfshirë numrin e ekipeve mjekësore dhe mbulimin e territorit.

Në këtë drejtim, komuna do të angazhohet për të: optimizuar përdorimin e mjeteve buxhetore në përputhje me prioritetet strategjike, forcuar kapacitetet për tërheqje fondesh alternative (donatorë, projekte IPA, PPP) dhe për të adresuar te niveli qendror nevojën për një rishikim të formulës së ndarjes së grantit, duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë zhvillimorë përtej numrit të banorëve.


10.3. Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afatmesëm 2027 - 2029

Sipas rekomandimeve të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore Komunale 2027/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2027, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje:

Tabela 2. Projektionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2027 do t'i paraqesim sipas kategorive ekonomike:

Kategoritë buxhetore	Vlera €	%
PAGA	12,919,962.00	59.53
MALLRA&SHËRBIME	2,821,000.00	13.00
SHPENZIME KOMUNALE	440,000.00	2.03
SUBVENCIONE	1,000,000.00	4.61
INVESTIME KAPITALE	4,523,286.00	20.84
TOTAL	21,704,248.00	100.00

Paraqitja grafike 2: Buxheti total i Komunës sipas kategorive ekonomike:



Sqarim për kategoritë ekonomike: Në përputhje me të dhënat paraprake të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) më 31 maj 2024, komuna e Rahovecit ka një popullsi prej 41,799 banorësh, e cila paraqet ulje të ndjeshme krahasuar me vlerësimet e mëparshme që janë përdorur në ndarjen e mjeteve buxhetore gjatë viteve të fundit. Kjo ulje e bazës demografike ka ndikuar drejtpërdrejt në formulën e financimit nga niveli qendror, duke reflektuar në zvogëlimin e përgjithshëm të buxhetit të ndarë për vitin 2027 dhe vitet pasuese. Si pasojë, struktura e shpenzimeve është rishikuar dhe përshtatur në mënyrë që të ruhet stabiliteti fiskal dhe të sigurohet efikasitet në ofrimin e shërbimeve publike. Faktor tjerë si: Kontrata Kolektive, në formë aktuale të zbatimit, ka ndikuar dukshëm në rritjen e obligimeve financiare të Komunës, duke e rënduar buxhetin komunal dhe duke kufizuar hapësirën për investime dhe politika të reja zhvillimore.

Kategoria e pagave dhe mëditjeve paraqet rritje në raport me vitin 2026, në përputhje me politikat nacionale për rritjen e pagës minimale dhe harmonizimin e koeficienteve në sektorin publik.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime, duke përfshirë edhe shpenzimet komunale, rriten krahasuar me vitin 2026. Kjo strukturë synon të ruajë funksionalitetin e përditshëm dhe mirëmbajtjen e shërbimeve komunale pa ngarkesa të reja.

Kjo strukturë e re është ndërtuar mbi parimet e menaxhimit të përgjegjshëm fiskal, transparencës dhe performancës, me qëllim të sigurimit të një planifikimi realist, të qëndrueshëm dhe në përputhje me nevojat aktuale të popullsisë së komunës.

10.3.1. Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2027, krahasuar me vitin 2026, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **3.74 %**. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe e mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **59.53 %**.

10.3.2. Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalitetë), ka pësuar rritje në vitin 2027, krahasuar me vitin 2026. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2027, pritet të jetë mesatarisht **13.00 %**.

10.3.3. Subvencionet

Në vitin 2027, Komuna e Rahovecit do të ndajë subvencionet për bujqësi, ekonomi, shëndetësi, arsim, kulturë, rini dhe sport dhe në kudër të shërbimeve publike. Gjatë vitit 2027, krahasuar me vitin 2026, kjo kategori e shpenzimeve pritet të mbetet e njëjtë. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë vitit 2027, mesatarisht, do të jetë: **4.61 %**.

10.3.4. Investimet kapitale

Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2027 është me **20.84 %**, në përputhje me kapacitetet aktuale financiare dhe qëllimet zhvillimore të përcaktuara në planifikimet komunale afatmesme dhe mundësitë buxhetore të komunës.

Tabela 3: Korniza Buxhetore Komunale 2027 - 2029, në euro.

N r.	Përshkrimi	2026	2027	2028	2029
			(plan)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
1	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	21,547,734.00	21,704,248.00	22,071,869.00	23,271,329.00
	Të Hyrat Vetanake	2,251,414.00	2,326,871.00	2,407,673.00	2,540,494.00
	Grandet dhe Transferet Qeveritare	19,296,320.00	19,377,377.00	19,664,196.00	20,730,835.00
2	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	21,547,734.00	21,704,248.00	22,071,869.00	23,271,329.00
	Shpenzimet rrjedhëse	16,605,561.00	17,180,962.00	17,250,062.00	17,676,332.00
	Pagat dhe Mëditjet	12,454,555.00	12,919,962.00	12,979,062.00	13,038,166.00
	Mallrat dhe Shërbimet	2,761,006.00	2,821,000.00	2,821,000.00	3,135,666.00
	Shpenzimet Komunale	390,000.00	440,000.00	440,000.00	492,500.00
	Subvencionet	1,000,000.00	1,000,000.00	1,010,000.00	1,010,000.00
3	Shpenzimet Kapitale	4,942,173.00	4,523,286.00	4,821,807.00	5,594,997.00
	Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve në komunë, në bazë të programeve apo të kategorive funksionale, si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 4) janë ato aktuale të vitit 2026, planifikimi për vitin 2027 - 2029, si dhe projeksionet (tabela 4-5-6-7).

Tabela 4: Shpenzimet në vitin 2026, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	24	220,000.00	55,000.00	-	230,000.00	-	505,000.00
Administrata	40	330,000.00	198,000.00	-	0.00	-	528,000.00
Çështjet Gjimore	1	9,172.00	2,000.00	-	0.00	-	11,172.00
Inspektimet	10	113,000.00	70,000.00	-	0.00	-	183,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	260,000.00	17,000.00	-	0.00	-	277,000.00
Buxhetimi	17	151,000.00	210,000.00	-	0.00	174,563.00	535,563.00
Infrastruktura publike	4	46,500.00	640,666.00	250,000.00	110,000.00	1,230,000.00	2,277,166.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	202,000.00	15,000.00	-	0.00	30,000.00	247,000.00
Zyra e Komuniteteve	12	112,000.00	15,000.00		0.00	20,000.00	147,000.00
Bujqësia	5	55,005.00	100,000.00	-	440,000.00	966,196.00	1,561,201.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	70,000.00	70,000.00	-	20,000.00	110,000.00	270,000.00
Shërbimet kadastrale	11	109,000.00	16,000.00	-	0.00	-	125,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	67,800.00	330,000.00	-	0.00	1,284,618.00	1,682,418.00
Shërbimet sociale	15	136,000.00	10,000.00	3,000.00	0.00	230,000.00	379,000.00
Shërbimet kulturore	13	118,968.00	80,000.00	-	120,000.00	299,000.00	617,968.00
Shëndetësia	198	2,052,616.00	450,000.00	70,000.00	80,000.00	85,000.00	2,737,616.00
Administrata e Arsimit	8	83,514.00	62,000.00	-	0.00	-	145,514.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	286,750.00	89,000.00	8,500.00	0.00	-	384,250.00
Arsimi fillor	675	6,480,094.00	233,237.00	43,500.00	0.00	512,796.00	7,269,627.00
Arsimi i mesëm	161	1,551,136.00	98,103.00	15,000.00	0.00	-	1,664,239.00
Total	1,290	12,454,555.00	2,761,006.00	390,000.00	1,000,000.00	4,942,173.00	21,547,734.00

Tabela 5: Shpenzimet për 2027, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	24	250,988.00	55,000.00	-	230,000.00	-	535,988.00
Administrata	40	382,944.00	178,000.00	-	-	-	560,944.00
Çështjet Gjinore	1	9,617.00	2,000.00	-	-	-	11,617.00
Inspektimet	10	117,350.00	70,000.00	-	-	-	187,350.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	260,275.00	17,000.00	-	-	-	277,275.00
Buxhetimi	15	154,567.00	230,000.00	-	-	180,000.00	564,567.00
Infrastruktura publike	4	47,056.00	600,000.00	300,000.00	100,000.00	1,300,000.00	2,427,716.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	205,797.00	15,000.00	-	0.00	-	220,797.00
Zyra e komuniteteve	12	118,452.00	15,000.00	-	0.00	20,000.00	153,452.00
Bujqësia	5	58,172.00	100,000.00	-	450,000.00	993,279.00	1,601,451.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	73,908.00	70,000.00	-	20,000.00	50,000.00	213,908.00
Shërbimet kadastrale	11	115,045.00	16,000.00	-	-	-	131,045.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	78,843.00	300,000.00	-	-	1,138,075.00	1,516,918.00
Shërbimet sociale	15	149,386.00	10,000.00	3,000.00	-	180,000.00	342,386.00
Shërbimet kulturore	13	127,140.00	80,000.00	-	120,000.00	144,136.00	471,276.00
Shëndetësia	198	2,116,095.00	450,000.00	70,000.00	80,000.00	-	2,716,095.00
Administrata e Arsimit	8	87,281.00	142,660.00	-	-	-	149,281.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	288,928.00	89,000.00	8,500.00	-	-	386,428.00
Arsimi fillor	675	6,700,252.00	283,237.00	43,500.00	-	517,796.00	7,544,785.00
Arsimi i mesëm	161	1,577,866.00	98,103.00	15,000.00	-	-	1,690,969.00
Total	1,288	12,919,962.00	2,821,000.00	440,000.00	1,000,000.00	4,523,286.00	21,704,248.00

Tabela 6: Shpenzimet për 2028, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	24	252,097.00	55,000.00	-	230,000.00	-	537,097.00
Administrata	40	384,695.00	178,000.00	-	-	-	562,695.00
Çështjet Gjimore	1	9,663.00	2,000.00	-	-	-	11,663.00
Inspektimet	10	117,883.00	70,000.00	-	-	-	187,883.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	261,510.00	17,000.00	-	-	-	278,510.00
Buxhetimi	15	155,298.00	230,000.00	-	-	230,000.00	615,298.00
Infrastruktura publike	4	47,269.00	680,660.00	300,000.00	110,000.00	1,400,000.00	2,537,929.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	206,715.00	15,000.00	-	-	-	221,715.00
Zyra e komuniteteve	12	119,007.00	15,000.00	-	-	20,000.00	154,007.00
Bujqësia	5	58,437.00	100,000.00	-	450,000.00	960,017.00	1,568,454.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	74,258.00	70,000.00	-	20,000.00	70,000.00	234,258.00
Shërbimet kadastrale	11	115,585.00	16,000.00	-	-	-	131,585.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	79,218.00	300,000.00	-	-	1,269,075.00	1,648,293.00
Shërbimet sociale	15	149,904.00	10,000.00	3,000.00	-	180,000.00	342,904.00
Shërbimet kulturore	13	127,716.00	80,000.00	-	120,000.00	174,919.00	502,635.00
Shëndetësia	198	2,125,993.00	450,000.00	70,000.00	80,000.00	-	2,725,993.00
Administrata e Arsimit	8	87,688.00	62,000.00	-	-	-	149,688.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	290,328.00	89,000.00	8,500.00	-	-	387,828.00
Arsimi fillor	675	6,730,707.00	283,237.00	43,500.00	-	517,796.00	7,575,240.00
Arsimi i mesëm	161	1,585,091.00	98,103.00	15,000.00	-	-	1,698,194.00
Total	1,288	12,979,062.00	2,821,000.00	440,000.00	1,010,000.00	4,821,807.00	22,071,869.00

Tabela 7: Shpenzimet për 2029, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	24	253,206.00	55,000.00		230,000.00	-	538,206.00
Administrata	40	386,447.00	260,000.00		-	-	646,447.00
Çështjet Gjimore	1	9,709.00	3,000.00		-	-	12,709.00
Inspektimet	10	118,416.00	80,000.00		-	-	198,416.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	262,746.00	18,000.00		-	-	280,746.00
Buxheti	15	156,029.00	250,000.00		-	274,503.00	680,532.00
Infrastruktura publike	4	47,483.00	643,666.00	335,000.00	110,000.00	1,610,000.00	2,746,149.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	207,634.00	18,000.00		0.00	-	225,634.00
Zyra e komuniteteve	12	119,561.00	18,000.00		0.00	20,000.00	157,561.00
Bujqësia	5	58,701.00	120,000.00		450,000.00	1,220,494.00	1,849,195.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	74,609.00	90,000.00		20,000.00	100,000.00	284,609.00
Shërbimet kadastrale	11	116,125.00	20,000.00		-	-	136,125.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	79,594.00	450,000.00		-	1,300,000.00	1,829,594.00
Shërbimet sociale	15	150,421.00	10,000.00	4,500.00	-	250,000.00	414,921.00
Shërbimet kulturore	13	128,293.00	80,000.00		120,000.00	170,000.00	498,293.00
Shëndetësia	198	2,135,891.00	500,000.00	80,000.00	80,000.00	-	2,795,891.00
Administrata e Arsimit	8	88,096.00	70,000.00	-	-	-	158,096.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	291,727.00	110,000.00	10,000.00	-	-	411,727.00
Arsimi fillor	675	6,761,162.00	240,000.00	45,000.00	-	650,000.00	7,696,162.00
Arsimi i mesëm	161	1,592,316.00	100,000.00	18,000.00	-	-	1,710,316.00
Total	1,288	13,038,166.00	3,135,666.00	492,500.00	1,010,000.00	5,594,997.00	23,271,329.00

Kategoria Ekonomike – Investimet kapitale - e prezantuar në detaje më lart, paraqet një komponent të rëndësishëm të buxhetit të komunës, e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Rahovecit.

Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës.

Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme.

Në këtë kontekst, përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjate.

Shpenzimet totale të buxhetit Komunal të vitit 2026 nga granti dhe të hyrat vetanake të bartura nga vitit 2025, si dhe donacionet në pesëmujorin e parë të këtij viti, kanë arritur shumën prej **11,698,884.78 €**, që përbën **52.76 %** të buxhetit total.

Tabela 8. Shpenzimet nga Granti (10) dhe të hyrat vetanake (21), të barturat (22), donacionet për vitin 2025, sipas kategorive ekonomike, deri më 31.5.2026

Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti i vitit 2026 sipas ligjit	Buxheti final 2026	Shpenzimi deri më datë 31.05.2026	Progresi përballë planit buxhetor 2026
Paga dhe Shtesa	12,454,555.00	12,454,555.00	6,041,384.04	48.51
Mallra dhe Shërbime	2,761,006.00	2,931,008.00	1,623,783.49	55.40
Shpenzime Komunale	390,000.00	425,539.62	202,773.65	47.65
Subvencione	1,000,000.00	1,050,000.00	454,237.89	43.26
Pasuritë jo Financiare	4,942,173.00	5,314,540.66	3,376,705.71	63.54
Total	21,547,734.00	22,175,643.28	11,698,884.78	52.76

Tabela 9. Shpenzimet nga Granti (10) dhe të H.V. të vitit 2024 (21), (22), donacionet sipas klasifikimit funksional (drejtorive), deri më 31.5.2026

Përshkrimi	Rregullorja Buxhetore 2026 Shuma e Buxhetit	Alokimi deri 31.05.2026	Aktuale (shpenzimet) Deri me 31.05.2026	Progresi përballë planit buxhetor 2026
Zyra e Kryetarit	505,000.00	191,431.98	152,499.03	30.20
Administrata	528,032.00	321,602.06	233,651.93	44.25
Çështjet Gjinore	11,172.00	6,260.79	4,817.05	43.12
Inspektimet	183,000.00	122,007.20	78,483.62	42.89
Zyra e Kuvendit Komunal	277,000.00	145,476.74	134,834.03	48.68
Buxhetimi	635,563.00	468,047.63	262,962.62	41.37
Infrastruktura publike	2,385,013.09	2,044,610.26	1,605,119.25	67.30
Zjarrfikësit dhe inspektimet	247,000.00	159,541.92	137,641.04	55.73
Zyra e Komuniteteve	147,029.00	47,261.79	38,187.58	25.97
Bujqësia	1,611,201.00	1,219,193.05	1,074,994.68	66.72
Planifikim i zhvillimit ekonomik	270,000.00	124,615.08	82,625.58	30.60
Shërbimet kadastrale	125,000.00	70,695.47	60,608.79	48.49
Planifikimi urban dhe inspeksioni	1,882,418.00	1,563,510.72	1,125,266.73	59.78
Shërbimet sociale	379,000.00	307,363.79	210,728.92	55.60
Shërbimet kulturore	617,968.00	505,819.87	261,870.67	42.38
Shëndetësia	2,817,616.00	1,664,752.15	1,375,267.04	48.81
Administrata e Arsimit	235,514.00	191,607.71	64,689.32	27.47
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	384,250.00	195,245.82	168,379.73	43.82
Arsimi fillor	7,269,627.00	3,951,785.94	3,822,358.11	52.58
Arsimi i mesëm	1,664,240.19	860,342.20	803,899.06	48.30
Total	22,175,643.28	14,161,172.17	11,698,884.78	52.76

XI. ANALIZA GJINORE - BUXHETIMI GJINOR

Komuna ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por jemi përpjekur të vlerësojmë se si shpenzimet në Paga dhe Mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe të burrave, të djemve dhe të vajzave të punësuar, në kuadër të Komunës (administratë, shëndetësi dhe arsim), si dhe kemi bërë një analizë të hollësishme të numrit të banorëve në proporcion të burrave dhe të grave. Andaj, kemi nxjerrë të dhëna të pjesëmarrjes së gjinisë femërore në kategorinë buxhetore për Mallra dhe Shërbime, si dhe Investime kapitale.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Në procesin e planifikimit dhe të shpenzimit për vitin 2027, Komuna e Rahovecit, duke u bazuar në ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 vitit 2015, një kujdes të veçantë i ka kushtuar buxhetimit gjinor. Komuna e Rahovecit, do të ketë në fokus të vazhdueshëm edhe parashikimin dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) dhe atë sipas praktikave më të mira, të grave dhe të burrave, në mënyrë që të kontribuohet në efektivitetin dhe në transparencën e menaxhimit të financave publike, duke bërë të dukshme efektet e shpenzimeve publike.

Duhet të kuptojmë çështjet gjinore brenda komunës, si balancë mes gjinive të të gjitha grupmoshave që përfshihen në planifikim të buxhetit. Me anë të një analize gjinore gjithëpërfshirëse, komuna mund të kuptojë se ku është i nevojshëm ndryshimi dhe si buxhetet dhe programet ekzistuese ndikojnë te burrat e gratë dhe a kanë fituar njëjtë nga programet e Komunës. Kjo mund të bëhet në faza të caktuara duke identifikuar qëllimet për të rritur barazinë në mes të grave dhe të burrave.

Me mbledhjen e informatave të nevojshme të shpërndarjes së buxhetit komunal, ne mund të identifikojmë këto pabarazi, të konstatuara gjatë fazës së përpilimit (planifikimit) buxhetor, duke përdorur analiza sasiore dhe cilësore nga të gjitha drejtoritë ose programet buxhetore.

Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve për gjininë femërore planifikojmë të buxhetojmë për vitin 2027 – 2029.

Tabela e mëposhtme bazohet në shifrat që janë sipas listës së Pagave dhe Mëditjeve, të muajit prill 2026 dhe numrin aktual të të punësuarve.

Tabela 10. Struktura e të punësuarve sipas gjinisë

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit - gra	Numri i stafit - burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2024	1233	583	650	4.487.500.56	5,240,614.92
2025	1307	624	683	5,365,484.68	5,496,707.00
Planifikimi 2026	1286	683	603	6,242,376.24	5,702,705.40
Planifikimi 2027	1288	-	-	-	-

Tabela 11. Planifikimi për vitin 2027 - Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Niveli i pagave	Numri i total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400	8	2	5,544.00	6	23,062.08
401-600	133	88	594,818.40	45	287,964.84
600+	1,121	506	5,102,343.12	613	5,931,349.44

Tabela 12. Numri i përfituesve të subvencioneve, të shërbimeve të ofruara nga komuna Rahovec të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri total i përfituesve-gra	Numri total i përfituesve për burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2025	1,010,000.00	569	366	203	151,480.80	549,530.30
Planifikimi 2026	1,000,000.00	-	-	-	-	-
Planifikimi 2027	1,000,000.00	-	-	-	-	-

Tabela 13. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor sipas kategorive ekonomike

Viti	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Subvencione	Investime Kapitale
2025	4,027,890.31	1,234,874.21	500,000.00	3,159,397.85
Planifikimi 2026	4,229,284.23	1,305,655.00	550,000.00	3,317,387.53
Planifikimi 2027	6,847,579.86	1,495,130.00	530,000.00	2,397,341.58

Në tabelën nr.13 është i përfshirë buxheti i përgjithshëm për gjininë femërore, si dhe projeksionet 2027. Në pozicionin Paga dhe Mëditje është e përfshirë gjinia femërore, të cilat janë të punësuar në kuadër të Komunës, duke përfshirë Administratën, Shëndetësinë dhe Arsimin, ku nga numri i përgjithshëm i të punësuarve prej 1286, janë 683 të gjinisë femërore me pjesëmarrje në Paga dhe Mëditje.

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, të dhënat janë nxjerrë nga numri i përgjithshëm i popullsisë së komunës së Rahovecit, prej 41,799 banorë, ku prej tyre, të gjinisë femërore janë: 20,879 ose 49.96 %.

Në kategorinë Investime Kapitale, të dhënat po ashtu janë nxjerrë nga numri i përgjithshëm i popullsisë së Komunës së Rahovecit, prej 41,799 banorë, ku prej tyre, të gjinisë femërore janë: 20,879 ose 49.96 %.

Kryetari i Komunës

Drejtorja për Buxhet dhe Financa